



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 12.03.2019, ora 10.30

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2016 për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike I””

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Ervin Bushati, Evis Kushi, Roland Xhelilaj, Vullnet Sinaj, Senida Mesi, Pjerin Ndreu, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj dhe Reme Lala.

Mungojnë:

Anastas Angjeli

Të ftuar:

Ilir Bejtja - Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Agim Bregasi – Drejtor në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ilda Malile - Drejtore e OSHEE-së

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Përshëndetje të gjithëve!

Hapim mbledhjen e komisionit për ditën e sotme. Në rendin e ditës kemi shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2016 për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike””.

Kemi të pranishëm nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë zëvendësministrin Ilir Bejtja dhe drejtorin Agim Bregasi.

Referuese është zonja Antoneta Dhima.

Zonja Antoneta, fjala për ju.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin financiar 2016 për projektin “Programi i investimeve për shpërndarjen e energjisë elektrike” është propozuar nga Këshilli i Ministrave. Komisioni për Ekonominë dhe Financat do ta shqyrtojë këtë projektligj në cilësinë e komisionit përgjegjës, në përputhje me procedurat e parashikuara në nenet 32 dhe 39 të Rregullores së Kuvendit.

Qëllimi, përmbajtja dhe risitë e këtij projektligji janë: kjo marrëveshje propozohet të ratifikohet në këtë projektligj dhe synon sigurimin e financimit të projektit. Ky projekt ka si qëllim përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve në rrjet, si dhe rritjen e cilësisë dhe sigurimin e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët.

Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të përfitojë një kredi të butë nga KfW-ja me vlerën e përgjithshëm deri në 30 milionë euro dhe një shumë të përgjithshme financimi me vlerë deri në 2 milionë euro për masat e nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtij projekti.

Kjo është një marrëveshje kuadër dhe financimi do të jepet për çdo projekt që do të mbështetet nga palët deri në fund të vitit 2022. Huaja mund t’i jepet drejtpërdrejt Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose u jepet huamarrësve të tjerë. Në këtë rast, Këshilli i Ministrave është në rolin e garantuesit. Përzgjedhja e huamarrjes do të bëhet bashkërisht nga të

dyja qeveritë. Marrëveshja mund të zbatohet edhe në periudha të mëvonshme nëse KfW-ja bie dakord të japë hua ose shuma të tjera financimi për këtë projekt.

Kredia e butë do të jepet në kuadër të bashkëpunimit publik për zhvillim. Kushtet për përfitimin e saj janë që Republika e Shqipërisë të vijojë të jetë e besueshme lidhur me kreditë dhe Këshilli i Ministrave të japë garanci shtetërore nëse nuk është vetë huamarrës.

Projekti për kredinë e butë nuk mund të zëvendësohet nga projekte të tjera.

Shuma e financimit mund të përdoret për projekte të tjera nëse të dyja palët do të bien dakord.

Marrëveshja është në përputhje me strategjinë kombëtare të energjisë për periudhën 2018-2030 dhe të gjitha dokumentet e tjera për mbështetjen e sektorit energjetik. Kjo ka rëndësi të veçantë, pasi do të kontribuojë në përmirësimin e rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, reduktimin e humbjeve në rrjet, si dhe rritjen e cilësisë dhe të sigurtisë në furnizimin e përdoruesve të energjisë elektrike. Financimi do të sigurohet nëpërmjet një kredie me terma të butë, duke mos rënduar buxhetin e shtetit. Për këto arsye u propozoj të gjithë kolegëve të komisionit miratimin e këtij projektligji.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zonja Dhima!

Zoti Bejtja e ka fjalën.

Ilir Bejtja – Së pari, zoti kryetar, ju falënderoj mbështetjen që na keni dhënë gjithmonë për sektorin!

Ne jemi sektori që ndoshta ju ka bezdisur më shumë me marrëveshje, por me të vërtetë e vlerësojmë shumë kontributin që është dhënë nga Komisioni i Ekonomisë, si dhe nga qeveria dhe Ministria e Financave që gjithmonë ka gjetur hapësira brenda tavaneve për ta mbështetur sektorin e energjisë. E them këtë, sepse ndokujt mund t'i lindi pyetja: pse sot dhe jo që nga 2016-ta?

Në fakt, ky është një proces që ka nisur shumë më herët dhe gjithmonë, ashtu siç ju e thatë edhe në relacionin tuaj, është kërkuar që ne të jemi me arritje me targetet e vendosura. Ky ka qenë kusht nga KfW-ja dhe qeveria gjermane, gjë që është dakordësuar me qeverinë tonë, me Njësinë e Detyrimit të Prioriteteve pranë Kryeministrit, po ashtu edhe nga Ministria e Financave dhe më në fund në sajë të performancës së OSHEE-së dhe Sektorit Elektroenergjetik ne sot jemi në gjendje ta thithim edhe këtë kredi dhe financim të ri prej 30 milionë eurosh, i cili do të ketë një shtrirje në

financim deri në vitin 2022, gjithmonë në funksion të arritjeve dhe targeteve të arritura nga ana jonë, të rialokuara së fundi me dy dokumente të rëndësishme.

Një prej këtyre dokumenteve është plani i mirëmëkëmbjes së sektorit, i rishikuar, i cili ka vendosur targete të reja, jo më ato akomoduese të vitit 2014, por kemi marrë vitin 2017, çka do të thotë se kemi objektiva më ambiciozë, të cilët nuk lidhen thjesht me mbulimin e territorit me shërbime dhe energji elektrike, por me rritjen e cilësisë dhe garantimin 100% të sigurisë së furnizimit.

Po kështu, kemi edhe një dokument tjetër, i cili është firmosur në bashkëpunim me qeverinë gjermane dhe bankën gjermane (KfW), i cili është firmosur më 12 dhjetor nga dy ministrat e asaj kohe Gjiknuri dhe Ahmetaj, të cilët kanë hapur një hapësirë të re për sektorin për të gjetur financim nga KfW-ja dhe nga AFD-ja, Banka Franceze tashmë është ofruar, gjithashtu, edhe shteti francez me financime në sektorin e energjisë, të cilat, siç e thatë edhe ju, janë gjithmonë të lidhura me performancën e sektorit. Pra, nuk janë thjesht hua që ta nxjerrin nga halli sektorin, por mbështesin zhvillimin e tij. Në këtë aspekt kjo kredi do të shërbejë në rritjen e cilësisë së kontrollit nëpërmjet sistemit *skata*, kryesisht në dy zona, si fillim në Tiranë dhe Durrës dhe në disa nënstacione, të cilat i shërbejnë po të njëjtin sistem të komanduar dhe të kontrolluar dhe po kështu në dy projektet që lidhen me linjat e tensionit të mesëm 20 kilovolt dhe tensionit të ulët ABC, që do të thotë se për herë të parë ne do të vlerësojmë sa janë humbjet në Shqipëri. Deri tani ne i dimë si humbje integrale, por që shpesh nuk i ndajmë dot nëse vijnë nga cilësia e rrjetit apo nga abuzimet me rrjetin. Kemi arritur në një pikë tashmë që kjo rregullohet jo me forcën e policisë apo me veprime administrative, por me investime.

Arben Ahmetaj – A keni ndonjë pyetje?

Senida Mesi- Unë doja një koment nga zoti Bejtja në lidhje me investimet, të cilat, në një moment të dytë, pas nënshkrimit dhe rimbursimit të kredisë, kërkojnë një shpërndarje edhe më të mirë. I referohem qarkut të Shkodrës, aty ku jam deputete, ku gjithmonë humbjet kanë qenë të mëdha për atë qark dhe është shumë e rëndësishme të zbulohen dhe të identifikohen edhe në këtë qark nëse humbjet vijnë nga abuzimi në rrjet, mospagesa apo nga problematika në rrjet.

Është e vërtetë që investimet e OSHEE-së në qarkun e Shkodrës kanë ardhur duke u rritur, por, sipas mendimit tim, nuk janë të mjaftueshme për të kompensuar gjithë ato humbje në rrjet apo amortizim të rrjetit duke filluar që nga qyteti, e aq më tepër në zonat periferike. Si rezultat

gjej rastin t'ju kërkoj që qarku i Shkodrës të hyjë në planet e investimit qoftë për matjet, qoftë edhe për përmirësimin e rrjetit të amortizuar.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zoti Vullnet.

Vullnet Sinaj- Së pari, do ta vlerësoja jashtë mase këtë marrëveshje të qeverisë shqiptare me qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë, sepse e dimë shumë mirë si është situata në linjat e shpërndarjes së energjisë elektrike, sidomos në zonat rurale. Kolegia foli për Shkodrën, unë do të flas për Bashkinë e Selenicës. E gjithë Shqipëria është në situatë të vështirë dhe shpresojmë që këto marrëveshje, që do të bëhen më pas, ose kontratat që do të lidhë qeveria apo marrës të tjerë, të jenë funksionale dhe të shërbejnë vërtet në ato zona, ku ka vërtet nevojë për përmirësim, për uljen e humbjeve, por njëkohësisht edhe për të realizuar furnizimin e vazhdueshëm me energji elektrike, sepse nuk janë vetëm problem humbjet në rrjet, por janë edhe ndërprerjet e vazhdueshme të rrjetit të energjisë elektrike. Në zonat rurale ka probleme me reshjet e shiut. Nuk është vendosur dorë për ndërrimin e izolatorëve që në vitin 1970. Ata të gjithë bien në masë, kur bie shi dhe fshatra të tëra rrinë në errësirë.

Sinqerisht, do ta vlerësoja dhe shpresoj që kjo marrëveshje të vazhdojë dhe të implementohet sa më shpejt nga qeveria dhe nga ata që do të marrin kredinë dhe do ta zbatojnë këtë marrëveshje.

Unë kisha një paqartësi në lidhje me nenin 4 të marrëveshjes, ku thuhet: “Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë, si dhe nxjerr sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.”

A mund të ma shpjegoni këtë nen, se nuk arrij ta kuptoj?

Arben Ahmetaj – Kjo është një klauzolë që rrjedh nga marrëveshja bazë, gjë që do të thotë se duke iu referuar marrëveshjes bazë, që i referohet lehtësimeve dhe përjashtimeve nga taksat dhe mbështetjes që duhet t'i japë klienti, (në rastin konkret qeveria shqiptare) për lehtësitë për konektivitetin, për lejet administrative, për dogana dhe për pagesën e taksave, ata e marrin *mot*

a mot, siç është në këtë marrëveshje dhe e fusin në të gjitha marrëveshjet konsektive të veçanta. Kjo u referohet gjithmonë lehtësive fiskale, lehtësive administrative dhe atyre procedurale.

Ilir Bejtja – Kjo është edhe me një nen pak më sipër, ku thuhet se qeveria është e lirë nëse nuk mund të përdorë fondet, ato mund të çohen edhe në infrastrukturë.

Arben Ahmetaj – Po, mund t'i çojë diku tjetër.

E dyta, Vullnet, situata energjetike krahasuar me vitin 2013-2014 është tejte e përmirësuar në të gjitha aspektet, qoftë në aspektin financiar. Sot OSHEE-ja është praktikisht në një situatë financiare shumë më të mirë nga sa ka qenë në vitin 2014, falë një reforme, një menaxhimi dhe një monitorimi shumë të mirë qoftë nga menaxhimi i sotëm i OSHEE-së, qoftë nga monitorimi që ka bërë ministria ndër vite dhe zëvendësministri së bashku me drejtorin personalisht në role detyre respektive.

Investimet janë të gjithanshme.

Për dijeninë tuaj, megjithëse Shqipëria është në konsolidim fiskal, sistemi energjetik merr financim të vazhdueshëm jo më nga një donator, siç ka qenë banka, por nga shumë, si dhe jo më thjesht *net landing*, e tha në një moment zëvendësministri, por të referuar në performancë. Humbjet janë ulur nga 48 në 25, variojnë...

Nga 48 në 24? Aq më mirë që është rekord. Po ia vutë veshin zëvendësministrit, SCADA do të na ndihmojë të kalojmë në një monitorim tjetër të humbjeve. Kjo ka qenë edhe arsyeja, por nuk po e them meqenëse edhe media nuk është këtej, pra aq më mirë akoma, mos e drejto, pse unë e kam liruar dorën te ky 30-milionësh kur kam qenë në Ministrinë e Financave: vetëm për ta hapur këtë mundësi. Kështu që vështirësitë në sistemin elektroenergjetik janë të shumta, siç kam edhe unë vështirësi në zonën time Rrogozhinë – Kavajë, siç iu referuat ju, por do ta shohim në retrospektivë dhe në perspektivë. Në retrospektivë kjo qeveri ka bërë një diferencë shumë të madhe në sistemin elektroenergjetik. Tani po kalon në një model të ri tregu, që është edhe më i shëndetshëm. Në të njëjtën kohë është përditësuar edhe projekti, që nuk është thjesht projekt, por është reformë: *power sector recovery program* dhe *project* nga Banka Botërore.

Gjithsesi, zoti Zëvendësministër, sigurisht që vështirësitë në terren, sidomos në zonat rurale, duke iu referuar asaj që tha edhe zoti Sinaj, janë të shumta. Unë e kuptoj shumë mirë edhe situatën elektroenergjetike, sidomos në një vit të thatë, ku importet po shkojnë gati te 100 milionë euro dhe ku detyrimi i OSHEE-së është të ndalojë investimet për t'u furnizuar apo për të pasur atë që zoti Sinaj iu referua si furnizim i vazhdueshëm. Gjithsesi, unë mendoj që së bashku do të

diskutojmë për një ditë dhe muaj ku të thërrasim këtu ministrinë dhe të tria kompanitë, që të na bëjnë një ekspozitë të plotë, duke iu referuar të kaluarës dhe tashmë...

(Deputeti Sinaj ndërhyr pa mikrofon.)

Ja, zoti Sinaj, një sekondë!

Tashmë do të flasim për të gjitha planet për të ardhmen dhe investimet, si dhe ku shkohet.

Faleminderit!

Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Kur folja, kisha parasysh situatën që është tani për ta krahasuar atë me qeverisjen e mëparshme, nuk ka krahasim, sepse më përpara situata elektroenergjetike në vend ishte lënë në rënie të lirë dhe nuk ishte bërë asnjë investim. Unë them që janë bërë përmirësime, por ka akoma për të bërë, sepse në zonat malore ka akoma probleme me izolatorët e të tjera.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po, zonja Blerina.

Blerina Gjylameti – Së pari, falënderoj zëvendësministrin për ekspozitën!

Zoti kryetar, duke qenë në të njëjtën linjë me atë çfarë thatë, lidhur me situatën e ndryshuar energjetike në Shqipëri, si për pjesën e reduktimit të humbjeve, që vërtet duhet thënë dhe përsëritur, sepse shpeshherë harrojmë se në çfarë situatë ishte dhe në çfarë momenti jemi, por kjo duhet parë edhe në këndvështrimin se çfarë do të duhet nga buxheti i shtetit për të mbështetur këtë sektor, por nga ana tjetër e kombinuar me atë çfarë biznesi pret nga ajo pjesë që ka të bëjë me një nga kushtet bazike, atë të infrastrukturës energjetike.

Pra, duke i përmendur të gjitha këto dhe meqenëse objektivi kryesor i këtij projektligj është ratifikimi i marrëveshjes për t'i hapur rrugë hyrjes në fuqi sa më shpejt, në mënyrë që të gjitha këto që thamë për problematikat që kemi në zona të caktuara, t'i adresojmë ashtu siç duhet nëpërmjet kësaj marrëveshjeje huaje. Unë mendoj ta votojmë dhe më pas t'i bashkëngjitem kërkesën tuaj dhe kërkesën që unë e kam bërë kur ishte zëvendësministri tjetër, për pjesën e një takimi me të tre drejtuesit e kompanive të shpërndarjes, transmetimit dhe prodhimit të energjisë. Kjo për të diskutuar se si ka qenë situata, duke e parë në këndvështrimin ekonomik, çfarë i është dashur buxhetit të shtetit për ta mbështetur këtë sektor, por edhe në këndvështrimin tjetër, nëpërmjet kësaj huaje, cili do të jetë plani i investimeve me objektiv ndërhyrjeje në zona të

caktuara, që më pas të mund të ketë zhvillim të mëtejshëm të biznesit, sidomos turizmit, duke qenë se jemi edhe në nisje të sezonit turistik.

Unë besoj se sot duhet t'i bëjmë një kërkesë ministrisë për t'i pasur drejtuesit në një seancë të mirëfilltë, ku të diskutojmë në të gjitha këndvështrimet, jo vetëm për pjesën e planit të investimeve, jo vetëm për përgjigjet e deputetëve për zonat e tyre, por edhe për pjesën e buxhetit të shtetit.

Arben Ahmetaj – Jo, për zonat e tyre nuk do të thërrasim as ministrinë dhe as...

Blerina Gjylameti – Kërkesa ime ishte në përgjigje të problematikave që ka pasur me planin e investimeve.

Arben Ahmetaj – Diskutime për zona specifike në këtë komision nuk ka. Këtu do të ketë për strategjinë, për planin, për investimet dhe për vizionin.

Atëherë, kalojmë në votimin në parim.

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin nen për nen.

Neni 1. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi

Kush është pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Kam dy njoftime për komisionin.

Së pari, kërkesa që përmendëm t'i bëhet me shkrim dhe ma sillni që ta firmos.

Së dyti, ditën e martë, në datën 19.03.2019, ora 10:30, do të zhvillojmë një seancë dëgjimore për raportimin vjetor të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2018, ku zoti Land Xhelili do të jetë referuesi. Gjithashtu, do të zhvillojmë edhe një seancë dëgjimore me kandidaturën për anëtar të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, zotin Denis Doralla, propozim i Bankës së Shqipërisë.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti